



Prishtinë, 05 qershor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1158_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin të ndërtuar në fshatin Dyz, ZK Dyz, me kapacitet të instaluar prej **25 kW** në Komunën e Podujevës, të datës 16.05.2019 me nr. prot. 300/2019 të aplikuesit Sami Uka (Dyz Berry Fruits), me adresë: fshati "Dyz", Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 05 qershor 2019 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET**- kërkesa e aplikuesit Sami Uka(Dyz Berry Fruits), për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në fshatin Dyz, ZK Dyz, me kapacitet të instaluar prej **25 kW**, që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Podujevës.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi Sami Uka (Dyz Berry Fruits), me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR- 90138425 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi Sami Uka, do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

Arsyetim

- o ZRRE, me datë 16.05.2019 nga aplikuesi Sami Uka (Dyz Berry Fruits), ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga



panelet solare/fotovoltaike, mbi objektin e ndërtuar në fshatinë Dyz, ZK Dyz, me kapacitet të instaluar prej **25 kW**, shifra e konsumatorit DPR- 90138425, Komuna e Podujevës.

- Aplikuesi, s'bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergetik Nr. 2084 të datës 03.04.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., projektin ekzekutues dhe Pëlqimin të datës 03.07.2018 të lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Podujevës.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit Sami Uka, dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në kulmin e shtëpisë individuale të ndërtuar në fshatinë Dyz, ZK Dyz, me kapacitet të instaluar prej **25 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejrićaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Podujevës,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.